



Pranimar / Dorezuar Priljeva/Prodato Received/Delivered	10.05	2	viti god year
Organ dëgjues Organ dëgjues Org thut	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2687/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.283/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.283/2022 të datës 24.03.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "*transferim*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.283/2022 e datës 24.03.2022, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 me 01nr.112-986 është e sistemuar në vendin e punës "*Zyrtare për shërbim me qytetar*", e cila me datë 25.11.2021 me numër protokollit 14-070/01-256374/21 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës për "*transfer të përhershëm brenda Shërbimit Civil*", mirëpo ankuesja nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj dhe me datë 05.01.2022 me numër të protokollit 06/2022 parashtron ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me datë 14.02.2022 merr vendimin me numër A.nr.04/2022 me të cilin vendim e obligon Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankueses të datës 25.11.2021.

Komuna e Prishtinës, duke e bërë zbatimin e vendimit me numër A.nr.04/2022 të datës 14.02.2022 i kthen përgjigje me datë 04.03.2022 ankueses me të cilën e njofton se kërkesa e saj për transferim të përhershëm nuk mund të aprovohet.

Ankuesja pa kënaqur me përgjigjen e datës 04.03.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 24.03.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 1564/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila kërkon që ti rishqyrtohet kërkesa për *“transfer të përhershëm brenda Shërbimit Civil”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 24.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e organit të punësimit e datës 04.03.2022; Vendimi A.nr.04/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankueses e datës 05.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 12.02.2021 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Kërkesa e ankueses e datës 25.11.2021; Raporti mjekësor i datës 04.06.2021, Raporti i Komisionit Konziliar i Reumatologëve e datës 02.03.2021; Vendimi i datës 03.09.2012 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i datës 27.08.2013; Akt emërimi i datës 01.02.2017; Kërkesa e datës 05.03.2021; E-mail i datës 11.02.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.06.2017 mbanë pozitën *“Zyrtare për Shërbim më Qytetar”* në Komunën e Prishtinës, ndërsa me datë 25.11.2021 e njëjta ka kërkuar nga Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore që t'i mundësohet transferi i përhershëm për shkak të problemeve shëndetësore e cila kërkesës ia ka bashkangjitur edhe raportin nga Klinika e Reumatologjisë/Komisioni Konziliar i Reumatologëve të datës 02.03.2021 dhe raportin e datës 04.06.2021 nga Konsulta me Specialistin e Psikiatrisë.

Menaxheri i Burimeve Njerëzore me datë 04.03.2022 me numër të referencës 14-070/01-42098/21 i përgjigjet kërkesës së ankueses lidhur me kërkesën e saj të datës 25.11.2021 për transferim duke e njoftuar se: *“për shkak se nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për transferim të përhershëm, kërkesa nuk mund të aprovohet”*.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e datës 04.03.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore me datë 24.03.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 1567/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila kërkon nga Këshilli që ti mundësohet transferimi i përhershëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me kërkesën e ankueses për transferimin e përhershëm të saj, ka konstatuar se në bazë të nenit 53 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L - 114 për Zyrtarët Publikë transferimi i përhershëm është i lejuar vetëm në rastet si në vijmë: ***“1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës”***, mirëpo ndërlidhur me këtë me nenin 11 paragrafi 3 të Rregullore (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ka përcaktuar se: ***“Për institucionet e***



tjera, njësia përgjegjëse merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe vendos për transferimin e nëpunësit brenda institucionit”, rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e ka shqyrtuar kërkesën e ankueses lidhur me transferim të përhershëm për shkak gjendjes shëndetësore mirëpo organi i punësimi gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore ka vlerësuar se natyra e punës e pozitës në të cilën kërkon të transferohet ankuesja respektivisht në pozitën “Zyrtare për Shërbime Sociale 1” është e ngjashme me pozitën „Zyrtare për Shërbim më Qytetar”, në të cilën është e sistemuar aktualisht ankuesja dhe se në të dy pozitat ankuesja ka punë me palë, andaj Kolegji konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, me rastin e refuzimit të transferit të përhershëm për shkaqe shëndetësore ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse në rastin konkret në pozitën të cilën ka insistuar të transferohet ankuesja përgjegjësitë dhe detyrat e punës janë të ngjashme me pozitën aktuale, përkatësisht dominon puna me palë dhe qëndrimi në këmbë, andaj Komuna e Prishtinës ka vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligji nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publike, ku përcaktohet se: **“Çdo institucion siguron një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune për mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe të dinjitetit të zyrtarit”** sepse transferimi në këtë pozitë nuk do të largonte shqetësimet dhe problemet shëndetësore të ankueses.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.283/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësës së Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.